



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS  
 AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2011

I DETYRUAR

VARIANTI **A**

E mërkurë, 1 qershor 2011

Ora 10.00

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Shkolla e mesme pedagogjike

**Udhëzime për nxënësin**

Testi është i ndarë në dy pjesë: gjuhë shqipe dhe letërsi.

Testi në total ka **25 pyetje**.

Në të dy pjesët ka pyetje me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në pyetjet me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për pyetjet me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7a	7b	7c	7d	8a	8b	8c	9
Pikët														
Kërkesa	10a	10b	10c	11a	11b	11c	12a	12b	13	14	15	16	17	18
Pikët														
Kërkesa	19	20	21a	21b	21c	22	23	24	25a	25b	25c	25d		
Pikët														

**Totali i pikëve**

**KOMISIONI I VLERËSIMIT**

1.....Anëtar

2.....Anëtar

**PJESA I****GJUHË SHQIPE**

Në kohën e pasdites po shëtisnin që të dy pranë e pranë në vendin nga dilnin bota për shëtitje.

Shiu tashmë kishte pushuar. Ta kishte ënda të shikoje ngjyrën e kaltër e shumë të bukur të qiellit. Aty-këtu, ca re, si elefantë të ngarkuar me pambuk, endeshin ngadalë nga një horizont në tjetrin, duke i dhënë pamjes një hijeshi më vete. Aq afër dheut dukej qielli, sa retë e dendura e të bardha si pambuk binin mbi majat e sukave dhe të pemëve, bëheshin copë-copë dhe dukej sikur qëndronin në vend. Dallëndyshet e sapoardhura dhe si të hutuara i gjeje kudo.

Toka, e çelur nga gëzimi, po fitonte sërishmi freskinë e saj nën afshin jetëdhënës të diellit dhe nën dritën e tij të bukur. Nga dheu i ujshëm dilte një avull që shkonte drejt nga qielli.

Era, që frynte lehtë, bënte që të fërfëllinin vetëm gjethet, pa trazuar fare degët. Duke parë se do të shpëtonte nga dora mizore e dimrit, toka po priste gjithë gaz pranverën dhe po ndodhej pranë të gjitha ndryshimeve të mëdha të natyrës. Me një fjalë, tokë e qiell po nënqeshnin të gëzuar.

*Fragment nga tregimi “Katër stinët” i N. Frashërit*

*Për pyetjet nga 1 deri në 6 rrethoni **vetëm** alternativën e saktë.*

1. Gjeni cili grup fjalësh është njësi frazeologjike. **1 pikë**
  - A) ta kishte ënda
  - B) aty-këtu
  - C) bëheshin copë-copë
  - D) pa trazuar fare degët
  
2. Qarkoni alternativën ku janë përdorur dy fjalë homonime. **1 pikë**
  - A) fryn erë – nuhat erën që ka
  - B) erë e fortë – e rreh era
  - C) era e djathit – rrush me erë
  - D) drejtimi i erës – i shpejtë si era
  
3. Fjala e nënvizuar në ndërtimin *si elefantë të ngarkuar me pambuk* është: **1 pikë**
  - A) fjalë e përngjitur
  - B) fjalë e formuar me paranyjëzim
  - C) fjalë e formuar me prapashtesë
  - D) fjalë e formuar me prapashtesë dhe paranyjëzim njëkohësisht
  
4. Në fjalinë *Me një fjalë, tokë e qiell po nënqeshnin të gëzuar* mbiemri është: **1 pikë**
  - A) pjesë e kallëzuesit emëror
  - B) rrethanor mënyre
  - C) përcaktor
  - D) përcaktor kallëzuesor

5. Fjalja *Dallëndyshtet e sapoardhura dhe si të hutuara i gjeje kudo* është: **1 pikë**

- A) fjali e thjeshtë dykryegjymtyrëshe
- B) fjali njëkryegjymtyrëshe me vetë të përcaktuar
- C) fjali njëkryegjymtyrëshe me vetë të përgjithësuar
- D) fjali njëkryegjymtyrëshe pavetore

6. Qarkoni fjalën e shkruar gabim. **1 pikë**

- A) qiell
- B) studjoj
- C) të dielën
- D) ndjenjë

7. Përcaktoni klasën e fjalëve të nënvizuara në fjalinë:

*Era, që frynte pranë pemëve, bënte që të fërfëllinin vetëm gjethet, pa trazuar fare degët.*

- a) që: \_\_\_\_\_ **1 pikë**
- b) pranë: \_\_\_\_\_ **1 pikë**
- c) vetëm: \_\_\_\_\_ **1 pikë**
- d) fare: \_\_\_\_\_ **1 pikë**

8. Tregoni në ç'kohë është folja në fjalinë e mëposhtme. Ç'loj kallëzuesi është?  
Shkruani formën e kësaj foljeje në vetën e parë njëjës të kohës së pakryer të lidhore, në formën veprorë.

*Shiu tashmë kishte pushuar.*

- a) koha e foljes: \_\_\_\_\_ **1 pikë**
- b) lloji i kallëzuesit: \_\_\_\_\_ **1 pikë**
- c) forma e foljes: unë \_\_\_\_\_ **1 pikë**

9. Përcaktoni rasën e trajtës së shkurtër në fjalinë e mëposhtme. **1 pikë**

*Aty-këtu, ca re, endeshin ngadalë nga një horizont në tjetrin, duke i dhënë pamjes një hijeshi më vete.*

Rasa: \_\_\_\_\_

10. Gjeni funksionin sintaksor të fjalëve të nënvizuara në fjalinë:

*Nga dheu i ujshëm dilte një avull që shkonte drejt nga qielli.*

- a) i ujshëm: \_\_\_\_\_ **1 pikë**
- b) një avull: \_\_\_\_\_ **1 pikë**
- c) që: \_\_\_\_\_ **1 pikë**

11. Gjeni një rrethanor në fjalinë e mëposhtme, tregoni llojin e tij dhe me se është shprehur.

*Aty-këtu, ca re, si elefantë të ngarkuar me pambuk, endeshin ngadalë.*

- a) rrethanori: \_\_\_\_\_ **1 pikë**
- b) lloji: \_\_\_\_\_ **1 pikë**
- c) shprehur me: \_\_\_\_\_ **1 pikë**

12. Gjeni llojin e fjalive të nënrenditura në fjalinë e mëposhtme.

Bëni skemën e fjalisë së përbërë.

*Nga dheu i ujshëm dilte një avull që shkonte drejt nga qielli, megjithëse dielli ishte fshehur mbas reve.*

- a) lloji i fjalive të nënrenditura: **2 pikë**
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- b) skema e fjalisë së përbërë: **1 pikë**

## PJESA II

### BALZAK

#### Evgjeni Grande (fragment)

Evgjeninë e kishte regjur vetmia. Ajo ishte në gjendje t'i shikonte dhe t'i gjykonte me sy të mprehtë ngjarjet rreth saj; e mësuar nga plaga e dashurisë dhe nga edukata, ajo i vërente çështjet thellë me intuitë. Ajo pat kuptuar dhe ish bindur se i shoqi dëshironte vdekjen e saj që t'i merre pasurinë, atë pasuri të madhe që ishte rritur edhe më tepër nga trashëgimi që la noteri, i ungji i kryetarit si dhe nga ajo e ungjit tjetër, abatit Krysho, të cilin zotit iu shkrep ta thërrasë pranë tij. Vajza buzëplatur dhe e vetmuar pat mëshirë për kryetarin; po zoti ia mori hakun për poshtërsinë dhe indiferencën e një bashkëshorti, i cili respektonte, si garancinë më të fortë, pasionin pashpresë që ushqente Evgjenia. T'i dhuronte një fëmijë, a nuk do të thoshte kjo që t'ia rrëzonte kryetarin të gjitha shpresat e egoizmit të tij, gëzimet dhe ambiciet e tij? Zoti e rrethoi robëreshën e tij me thasë plot me florinj. Po kësaj gruaje nuk i bënte asnjë përshtypje ari. Ajo i kishte varur të gjitha shpresat e saj në qiell. Jetonte e devotshme, pa bërë zhurmë, ndihmonte vazhdimisht dhe fshehurazi fatkeqët.

Kështu zonja De Bonfons mbeti e ve në moshën 33 vjeç, me një pasuri prej tetëqindmijë frangash të ardhura në vit, akoma e bukur ashtu siç mund të jetë një grua që ecën drejt të dyzetave. Fytyra e saj është e bardhë, e qetë, zëri i saj i ëmbël, i butë dhe sjelljet e saj të thjeshta. Në zemrën e saj ka bërë fole fisnikëria që rrjedh prej dhembjes dhe shenjtëria e një njeriu që nuk e ka njollësuar kurrë shpirtin në kontakt me botën e jashtme. Po në të njëjtën kohë, ajo ka marrë tiparet e një vajze të plakur dhe zakonet bajate që rrjedhin nga jeta e mbyllur e provincës. Megjithëse ka tetëqindmijë franga të ardhura, ajo vazhdon të jetojë ashtu si jetonte dikur e shkreta Evgjeni Grande. Zjarrin e ndez vetëm ato ditë që e lejonte i ati dhe e shuan sipas programit të ditëve të çupërisë së saj. Vazhdon të vishet si e ëma.

Shtëpia e saj në Somyr, pa diell, pa ngrohtësi, e zymtë, melankolike, është pasqyra e gjallë e jetës së saj. Vazhdon të grumbullojë me kujdes të ardhurat dhe ndofta tek-tuk ka ndonjë që e quan koprrace dhe zemërngushtë. Po këto thashetheme ajo i përgënjeshton me përdorimin fisnik të pasurisë së saj. Ajo ngriti institute mirëbërësie, një azil për pleqtë, hapi shkolla fetare për fëmijët dhe një bibliotekë publike, me gjithë pajisjet. A nuk mjaftonin këto që t'ua mbyllnin gojën atyre që llomotitnin poshtë e lartë për koprracinë e saj? Zonja De Bonfons, që disa me tallje e quanin "zonjushë", frymëzon ndër të gjithë respektin më të thellë. Ajo i zbukuroi kishat e Somyrit... Po megjithatë, në atë zemër fisnike që rrihte vetëm për ndjenjat më ledhatare, tashti nisi të rëndonte pesha e interesit dhe e llogarive. Dhe ngjyra e ftohtë e parasë filloi të pasqyrohej në atë jetë qiellore dhe ta bënte të humbiste besimin ndaj ndjenjave, atë grua që ish kokë e këmbë ndjenja.

- Vetëm ti më do në këtë botë, - i thosh Nanosë.

Dora e kësaj gruaje shëron plagët e fshehta të atyre që vuajnë. Evgjenia po ecën në rrugën drejt qiellit, e shoqëruar nga shumë vepra mirëbërëse. Madhështia e shpirtit të saj ia mbulon vogëlsitë, edukatën dhe zakonet e saj të përditshme.

Kjo është historia e kësaj gruaje, e cila, ndonëse jetoi në këtë botë, nuk ish për këtë botë. Ajo qe lindur për të qenë grua e shkëlqyeshme dhe nënë; dhe tashti s'ka as burrë, as familje, as fëmijë.

*Shënim:*

*De Bonfons ~ Në këtë fragment, Evgjeni Grande shpesh prezantohet me mbiemrin De Bonfons, të cilin e ka marrë pas martesës.*

Për pyetjet nga 13 deri në 19 rrethoni **vetëm** alternativën e saktë.

13. Ç'cilësi e karakterit të bashkëshortit të Evgjenisë zbulohet në marrëdhënien që ai ka me të? **1 pikë**
- A) Egoizmi  
B) Përulësia  
C) Vetëmohimi  
D) Përkushtimi
14. Evgjenisë nuk i bën më asnjë përshtypje *ari*, sepse: **1 pikë**
- A) ajo e di që s'është i saj.  
B) vlera e tij kishte filluar të binte.  
C) ai nuk ia rikthen dot dashurinë e humbur.  
D) mendon se i mjafton për të gjithë jetën që i mbetet.
15. Në cilën nga alternativat e mëposhtme është përdorur metafora? **1 pikë**
- A) Zjarrin e ndez vetëm ato ditë që e lejonte i ati.  
B) Po kësaj gruaje nuk i bënte asnjë përshtypje ari.  
C) Ajo i vërente çështjet thellë me intuitë.  
D) Në zemrën e saj ka bërë fole fisnikëria.
16. Cili është sinonimi i fjalës *regjur* në fjalinë e mëposhtme? **1 pikë**  
Evgjeninë e kishte **regjur** vetmia.
- A) nënshtruar  
B) stërvitur  
C) pushtuar  
D) lodhur
17. Evgjenia mund të përshkruhet si një grua: **1 pikë**
- A) cinike dhe egoiste  
B) e ftohtë dhe indiferente  
C) fisnike dhe e virtytshme  
D) e dashur dhe gazmore
18. Evgjenia e ndien se mund të mbështetet vetëm te: **1 pikë**
- A) i shoqi.  
B) Nanoja  
C) abati Krysho.  
D) njerëzit që vuajnë.
19. Në cilën nga alternativat e mëposhtme mbiemri është përdorur me kuptim të drejtpërdrejtë? **1 pikë**
- A) Ngjyra e ftohtë e parasë  
B) Shtëpi melankolike  
C) Fytyrë e bardhë  
D) Zakonet bajate

**20.** Disa zakone të vjetra mbeten të rrënjosura te Evgjenia edhe pse është mjaft e pasur.  
Gjeni në fragment dy të tilla, që dëshmojnë jetën që ajo bën tashmë. **2 pikë**

a) \_\_\_\_\_

b) \_\_\_\_\_

**21.**  
a. Ku qëndron ndryshimi më i madh midis saj dhe të atit? **1 pikë**

\_\_\_\_\_

b. Evgjenia jeton në një mjedis provincial. Cili është një tipar dallues i këtij mjedisi? **1 pikë**

\_\_\_\_\_

c. Pse Evgjenia i përkushtohet kaq shumë bamirësisë? **1 pikë**

\_\_\_\_\_

**22.** Cila është figura e stilistikës që përdor Balzaku për të përshkruar Evgjeninë?  
Me ç'pjesë të ligjëratës krijohet ajo? **2 pikë**

a. figura: \_\_\_\_\_

b. pjesa e ligjëratës: \_\_\_\_\_

**23.** Shpjegoni dramën e madhe të jetës së Evgjeni Grandesë. Mbështeteni mendimin tuaj me  
ilustrime nga fragmenti. **3 pikë**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**24.** Ç'ndjesi ju shkakton ky fragment, që është edhe mbyllja e romanit? Cili është mendimi  
i parë që ju lindi kur e mbaruat së lexuari? **2 pikë**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

